



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE**  
**KOLEGJI DOKTORAL**

**MODALITETET PËR PRANIMIN E STUDENTËVE NË PROGRAMIN E**  
**CIKLIT TË TRETË TË STUDIMIT “DOKTORATË NË ALBANOLOGJI”,**  
**PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024**

Programi i studimit “Doktoratë në albanologji” përfshihet në ciklin e tretë të studimeve universitare, në përfundim të të cilit lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor i shkencave në albanologji”. Programi i doktoratës synon të nxisë kërkimin shkencor, duke u orientuar drejt thellimit, rikonceptimit dhe riintegritimit të njohurive shkencore, për të sjellë risi në mendimin shkencor.

Për të kryer regjistrimin në programin e studimit të doktoratës, aplikanti duhet të plotësojë këto kritere:

- të ketë përfunduar studimet e larta në shkencat albanologjike dhe të zotërojë një diplomë të ciklit të dytë “Master i shkencave”/“Master i arteve”; një diplomë të integruar të nivelit të dytë, ose një diplomë sipas sistemit të vjetër apo titull akademik të barasvlershëm, të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga organet kompetente;
- të ketë notë mesatare, mbi 8 (tetë) në studimet e ciklit të parë dhe të dytë; Përrjashtohen nga plotësimi i notës mesatare, kandidatët e diplomuar jashtë vendit;
- të ketë mbrojtur një nga gjuhët e huaja: *anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht ose spanjisht*, në përputhje me nivelet e parashikuara në Udhëzimin Nr. 52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar (pika 3) sipas Udhëzimit Nr. 10, datë 16.06.2023, të MAS.  
Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri;
- të ketë dy rekomandime nga persona, që kanë titullin Profesor ose Profesor i Asociuar, të cilët njohin aftësitë kërkimore shkencore dhe profesionale të kandidatit;
- të ketë paraqitur projektin kërkimor, në përputhje me projektin “Albanologjia dhe realitetet e reja në metodologji dhe burime”, në momentin e aplikimit;
- të paraqesë një përmbledhje të temës së masterit (4 faqe), për studentët që zotërojnë një diplomë të ciklit të dytë “Master i shkencave”/“Master i arteve”;
- të ketë publikime të mëparshme kërkimore shkencore;
- të mos jenë marrë masa disiplinore ndaj tij apo të mos jenë gjetur shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale apo



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE**  
**KOLEGJI DOKTORAL**

shkelje të rregullave kundër plagjiaturës, si edhe të vetëdeklarojë se është në gjendje të zbatojë standardet shkencore dhe etike.

Aplikanti për të ndjekur programin e studimit të doktoratës bën një kërkesë, ku paraqet edhe propozimin për temën dhe objektivat e kërkimit shkencor. Kërkesa me propozimin e kandidatit përfshihet në dosjen personale, e cila përmban edhe dokumentet e mëposhtme:

- curriculum vitae;
- kopje të noterizuar të diplomave, të shoqëruara me suplementet e diplomës ose listën e notave me kreditet përkatëse. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të shoqërohen me vërtetimin e njohjes/ekuivalentimit nga ministria përgjegjëse për arsimin;
- certifikatë lindjeje, si edhe fotokopje të kartës së identitetit/pasaportës;
- dy rekomandime nga persona me titullin Profesor ose Profesor i Asociuar;
- dëshmi të gjuhës së huaj, në përputhje me nivelet e parashikuara në Udhëzimin Nr. 52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar (pika 3) sipas Udhëzimit Nr. 10, datë 16.06.2023, të MAS.

Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri;

- dëshmi dhe vërtetime në lidhje me kualifikime, trajnime, provime pasuniversitare ose artikuj shkencorë që mund të ketë kryer, pjesëmarrje në konferenca shkencore apo përvoja akademike;
- deklaratë vetjake e studentit për përballimin e shpenzimeve të programit të studimeve të doktoratës, nëse do të vetëfinancohet;
- projekt propozimin e kërkimit shkencor, ku të evidentohen qëllimi dhe objektivat, metodologjia që do të ndiqet, nevoja për studim të thelluar në fushën e propozuar dhe risitë që pritet të sjellë punimi; Projekt propozimi duhet të jetë në përputhje me projektin kërkimor zhvillimor “Albanologjia dhe realitetet e reja në metodologji dhe burime”, të aksesueshëm në:

<https://uniel.edu.al/fakultetet/fakulteti-i-shkencave-humane/njofitime>.....

- vërtetim nga qendra e punës, nëse kandidati është i punësuar;
- mandat pagesa për tarifën e aplikimit, mund të gjendet në:



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”  
FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE  
KOLEGJI DOKTORAL**

<https://uniel.edu.al/zona-e-sherbimeve>

- vetëdeklarim të aplikantit se do të zbatojë standardet shkencore dhe etike;
- vetëdeklarim që nuk është subjekt i asnjë mase disiplinore të marrë ndaj tij.

Aplikanti duhet të dorëzojë dokumentacionin e sipërkërkuar, në rrugë postare, për periudhën **2.05.2024 – 8.05.2024** në adresën:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”**

**Aplikim për *doktoraturë***

**Fakulteti i Shkencave Humane**

**Elbasan**